



---

*4/41-V2  
Rregullore  
Maj/2020*

**RREGULLORE  
PËR REGJISTRIMI I STUDENTËVE**

---

**PRISHTINË, Maj 2020**

Mbështetur në dispozitat respektive të LIGJIT Nr. 04/L-037 PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, si dhe dispozitës së nenit 88 të Statutit të BPrAL Kolegji Presidenti më datën **15.05. 2019**, miratoi këtë:

## **RREGULLORE**

### **PËR REGJISTRIMI I STUDENTËVE**

#### **Neni 1**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

- 1.1. Me këtë rregullore përcaktohen kriteret themelore akademike dhe administrative në procesin e regjistrimit të studentëve në Kolegjin UBT.
- 1.2. Kolegjin UBT është i obliguar që të bëjë planifikimin e regjistrimit të studentëve të rinj për çdo vit akademik, në përputhje me kushtet ligjore në fuqi.
- 1.3. Regjistrimi i studentëve bëhet në bazë të konkursit të shpallur në mjetet e informimit publik dhe respektimit të kriterëve akademike e ligjore.
- 1.4. Regjistrimi i studentëve bëhet mbi bazën e nënshkrimit të një kontrate apo një marrëveshje ndërmjet Kolegjit UBT dhe studentit me anën e të cilës përcaktohen obligimet e të dy palëve kontraktuese.

#### **Neni 2**

#### **Planifikimi**

- 2.1. Regjistrimit të studentëve i paraprinë një proces i planifikimit të mirëfilltë dhe i saktë, që është i mbështetur në kapacitetet akademike, fizike, administrative, financiare si dhe në përputhje me ligjin dhe kërkesat e ekonomisë së tregut.
- 2.2. Planifikimi përfshinë numrin e përgjithshëm të studentëve që mund të regjistrohen në secilin program studimore të akredituar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës dhe licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).
- 2.3. Planifikimi i regjistrimit të studentëve bëhet për secilin vit akademik së paku një muaj para shpalljes së konkursit publik për regjistrim. Plani i regjistrimit të studentëve miratohet nga Rektorati me një vendim të veçantë.

### **Neni 3**

#### **Konkursi**

3.1. Për regjistrimin e studentëve në vitin vijues akademik, UBT është e obliguar të shpallë konkurs në mjetet e informimit publik apo edhe në mjetet e komunikimit masiv, varësisht se me cilin mjet të informimit, Kolegji do të jetë më afër kandidatëve potencial të tij.

3.2. Me konkurs shpallet numri i përgjithshëm i studentëve të rinj që mund të regjistrohen në vitin e parë të studimeve baçelor sipas programeve përkatëse, të studimeve master dhe atyre të doktoratës.

3.3. Në konkurs shpallen të drejtat e kandidatëve për konkurrim, kriteret dhe kushtet e regjistrimit. Kandidatët duhet të informohen për dokumentet e nevojshme, për procedurën e konkurrimit dhe vendin për konkurrim.

3.4. Konkursi mund të jetë i hapur deri në plotësimin e vendeve të lira të shpallura me konkurs, por jo më vonë se 1 tetor të vitit të ri akademik.

### **Neni 4**

#### **Procedura e konkurrimit**

4.1. Kandidatët e interesuar për konkurrim dhe regjistrim mund të marrin informata plotësuese shtesë, përpos konkursit, në kolegji nëpërmjet telefonit, internetit apo drejtpërdrejt në Kolegji në zyrën për pranimin e studentëve dhe të pajisen me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë profesionale.

4.2. Zyra për pranimin e studentëve në bashkëpunim me zyrën për informim dhe promovim, përgjegjësin e fakultetit janë përgjegjëse për informimin e plotë dhe të drejtë të kandidatëve në lidhje me të gjitha procedurat dhe procesin e regjistrimit. Ata e informojnë kandidatin edhe për të gjitha mundësitë, që kolegji u ofron atyre gjatë studimeve themelore, master dhe të doktoratës dhe gjithashtu e pajis me material informativ përkatës për fushën e interesuar.

4.3. Kandidatët janë të obliguar që brenda afatit të shpallur me konkurs të paraqesin kërkesën për regjistrim, të cilës ia bashkëngjisin dokumentet e nevojshme, si: dokumentin origjinal publik pedagogjik për shkollimin përkatës të kryer, certifikatën e lindjes dhe dy fotografi.

4.4. Kandidatët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në studimet themelore duhet të posedojnë dokumente administrative të vlefshme, dokumente pedagogjike origjinale nga shkollimi i mesëm i lartë (niveli 3 sipas ISCED) dhe të vërtetuara nga institucionet zyrtare përkatëse. E njëjta procedurë vlen edhe për kandidatët që dëshirojnë që të regjistrohen në studimet e master dhe ato të doktoratës.

4.5. Nëse zyrtari i kolegjit dyshon për origjinalitetin e dokumentit përkatës duhet të kërkojë ndihmën e organeve zyrtare arsimore për verifikimin e tyre. Nëse kandidati për regjistrim ka dokumentacion pedagogjik të lëshuar nga institucione zyrtare arsimore jashtë vendit në përputhje me aktet nënligjore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Zyrtari mund ta fillojë procedurën e regjistrimit përderisa kandidati është i obliguar ta sjellë dokumentacionin përkatës sipas procedurës paraprahe.

4.6. Kandidatët të cilët konkurrojnë dhe i plotësojnë kushtet për regjistrim në studimet themelore, para se të regjistrohen i nënshtrohen një testi provues për të vlerësuar shkallën e gatishmërisë së tyre në përballimin e planprogramit mësimor në studimet përkatëse. Varësisht nga rezultatet e testit, kolegji organizon kurse plotësuese për ngritjen e diturive me qëllim që gjatë studimit, studentët të mos kenë probleme në zotërimin e objektivave të planprogrameve të drejtimeve përkatëse.

## **Neni 5** **Regjistrimi**

5.1. Kandidati që i ka plotësuar të gjitha kushtet administrative dhe pedagogjike, konsiderohet i regjistruar vetëm atëherë kur bën nënshkrimin e kontratës apo marrëveshjes për studim me kolegjin.

5.2. Në kontratë përcaktohen dispozitat e përgjithshme, obligimet e të dy palëve, çmimi i studimeve për një vit akademik i cili caktohet me një vendim të veçantë nga Rektorati për çdo vit akademik, mënyra e shkëputjes së kontratës, të drejtat e palëve kontraktuese dhe e drejta e ankimit në rast të mosmarrëveshjes. Kontratës mund t'i bashkëngjitet edhe një aneks kontratë apo aneks marrëveshje për të precizuar kushtet dhe obligimet specifike të studimit për studentët përkatës.

5.3. Kontrata e merrë fuqinë ligjore kur të dy palët pajtohen me kushtet dhe obligimet që rrjedhin nga kontrata dhe nënshkruhet nga të dy palët.

5.4. Me rastin e regjistrimit, studentit i hapet dosja e tij personale dhe pajiset me dokument identifikues përkatës, kartelën e identifikuese të studentit. Studenti është i obliguar që në hapësirat e UBT-së të mbajë me vete kartelën identifikuese dhe ta tregojë atë sa herë që zyrtarët e kolegjit ta kërkojnë për nevoja zyrtare identifikimi. Secili student regjistrohet në platformën elektronike të UBT-se (SMIS) dhe platformën elektronike të MASH-it (SMIAL) në fillim të vitit të parë të studimeve themelore, studimeve master dhe të doktoratës dhe përcillet deri në diplomimin e tij me shënimet përkatëse.

5.5. Kur kandidati regjistrohet, ai merr statusin e studentit të kolegjit dhe është shfrytëzues dhe kontribuues i tij me të gjitha të drejtat e përcaktuara me këtë rregullore dhe aktet tjera juridike e pedagogjike të UBT-së.

#### **Neni 6 Hyrja në fuqi**

6.1. Kjo Rregullore hynë në fuqi tetë (8) ditë pas nënshkrimit të sajë, si dhe publikimit në Tabelë për Shpallje të UBT.

**PRISHTINË,**  
**Datë, 15.05.2019 viti**

**BPrAL Kolegji UBT**  
**PRESIDENTI**  
**Prof. Dr. Edmond HAJRIZI**

---